



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:060088

Datë: 25.05.2022

Numri i dokumentit: 03057093

PKR.nr.52/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË- DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Merita Xharavina, zyrtare ligjore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. Z. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.147/2022 të datës 31.03.2022, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me datë 05.05.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj dhe të akuzuarit, me datë 10.05.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 25.05.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

M. Z., nga i ati Sh. dhe e ëma N., e gjinisë B., i lindur me datë 04.08.1991, në fshatin S., Komuna e Gjakovës, ku dhe tani banon, me nr. personal....., nuk din shkrim lexim, i gjendjes së dobët ekonomike – shfrytëzues i ndihmës sociale, i papunë, i martuar, i ati i dy fëmijëve, egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, pasi që më parë ka siguruar e gjerë me dt.10.10.2019 ka mbajtur në pronësi armën në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par. 1.1 të ligjit për Armët të Republikës së Kosovës dhe atë një pistoletë të llojit “Jenning S3.22” pa nr. serik dhe një karikator për të njëjtën armë, në atë mënyrë që ditën kritike kjo armë i është gjetur nipit të tij-të miturit G.RR derisa ishte në shkollë përkatësisht në shkollën fillore “U. M.” në fshatin S., Komuna e Gjakovës, nga drejtori i kësaj shkolle Sh. D. ku edhe e kishte njoftuar policinë, me ç’rast arma dhe municioni i lartcekur është sekuestruar prej të miturit G.RR nga ana e zyrtarëve policor.

-Me çka ka kryer veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 46 par.1, pika 1.1, 47, 48, 49, 69 e 70, dhe nenit 366 paragrafi 1 dhe 3 të KPRK-së (Kodi Nr. 06/L- 074), si dhe neneve 245, 248, 360, 365, 366, 453 par.3 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që, të akuzuarin M. Z., e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën tjetër penale.

Në kuptim të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit, bëhet konfiskimi i: armës së tipit pistoletë të llojit “Jenning S3.22”, pa nr. serik dhe një karikator për të njëjtën armë, sipas listës së armëve të sekuestruara, me nr. të rastit, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara do të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se të njëjtat janë përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L022).

I akuzuari M. Z., lirohet nga obligimi që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale, pasi që i njëjti është shfrytëzues i ndihmës sociale, e kjo vërtetohet nga kartela e ndihmës sociale, me nr.37310, që e posedon i akuzuari.

A r s y e t i m

1. Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën, PP/I.nr.147/2022 të datës 01.04.2022, ndaj të pandehurit M. Z. nga fshati S., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe të njëjtën e ka dorëzuar në gjykatë, me datë 01.04.2022.

Gjykata, me datë 05.05.2022, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë marrë pjesë: Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj dhe i pandehuri M. Z. .

Prokurorja e shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

2. Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit ia ka dhënë mundësinë që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprkasht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që ngarkohet.

I akuzuari duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë, ka shtuar, se: e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, por njëherit e ka njoftuar gjykatën se armën për të cilën akuzohet e ka gjetur derisa ka qenë duke mbledhur hekura dhe e njëjta ka qenë e ndryshkur. Armën e kishte lënë në shtëpi dhe në ndërkohë e ka marr miku i tij, ndërsa ai nuk e kam ditur një gjë të tillë. Po ashtu, ka shtuar se e njëjta nuk ka pasur fishekë dhe ka qenë e pa përdorshme. Andaj, edhe njëherë ka theksuar se e pranon fajësinë dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, andaj, e ka lutur gjykatën që me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh të lartcekurat si dhe faktin se është mbajtës i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, jeton nga ndihma sociale me të cilën nuk arrin që ti mbulon as shpenzimet e ushqimit për veten, bashkëshorten dhe dy fëmijët, kështu që, t'ia shqipton një dënim sa më të butë bazuar në ligj.

3. Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së të akuzuarit për veprën penale për të cilën është ngarkuar meqenëse pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, po ashtu pranimi i fajësisë është bërë nga i pandehuri në mënyrë të vullnetshme dhe pa presion duke i ditur pasojat e pranimit të fajësisë, andaj, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

4. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga nenet 246 dhe 248 par. 1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues sidomos duke u mbështetur në vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka aprovuar pranimin e fajësisë së të njëjtit dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Gjykata, ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e ka marrë në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Deklarata e të pandehurit M. Z., e dhënë në Polici me dt.13.10.2019 dhe në Prokurori, me dt.31.03.2022;
- Raporti i dëshmitarit Sh. D., i dhënë në Polici me dt.10.10.2019 dhe në Prokurori me dt.31.03.2022;
- Raporti fillestar i incidentit me nr..... dt.10.10.2019;
- Lista e armëve të sekuestruara me nr. dhe datë të njëjtë, si dhe
- Fotoalbumi dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimit të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar

si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij, me ç'rast përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i akuzuari i lartcekur, është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohet.

5. Gjetjet e Gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit si dhe lidhur me konfiskimin

Gjykata, gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese, gjykata për të akuzuarin, ka vlerësuar dashjen direkte lidhur me veprat penale, e po ashtu edhe faktin se veprat penale të armëmbajtjes pa leje janë të shpeshta në regjionin ku jeton i akuzuari.

Gjykata, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin e parë, ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, është i papunë dhe jeton nga ndihma sociale në bashkësi familjare me bashkëshorten dhe dy fëmijët, ka shprehur gatishmëri të lartë për bashkëpunim, si me organet e ndjekjes ashtu edhe me gjykatën, me ç'rast e ka pranuar fajësinë, pendimin e thellë për veprimet e tij, është hera e parë dhe e vetme që ka rënë në kundërshtim me ligjin, premtimin që në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën, e posaçërisht si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin se i njëjti nuk e ka përdorur armën.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari e ka kryer veprën penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjykata, në kuptim të nenit 282 paragrafi 1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPPRK-së, dhe nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm, dhe atë: armën e tipit pistoletë të llojit "Jenning S3.22" pa nr. serik dhe një karikator për të njëjtën armë, sipas listës së armëve të sekuestruara, me nr. të rastit, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara do të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se të njëjtat janë përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L022).

6. Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 453 paragrafi 4 të KPP-së.

7. Arsyet lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.52/2022 datë 25.05.2022

Zyrtarja Ligjore,
Merita Xharavina

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Ilir I. Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.